



Hulumtim

“Narkotikët në shkollën e mesme Dr. Shaban Hashani” - Ferizaj

Lënda: Metodat Hulumtuese

Departamenti: Gjuhë dhe Letërsi Angleze

Student:
Sara Jashari

Mentor:
Prof. Teuta Agai Demjaha

Maj 2018



Kolegji Universum

DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE SHKENCORE

Autor:

Sara Jashari

Botues:

Departamenti i Kërkimeve Shkencore
Instituti për Studime Ekonomike dhe Sociale
Kolegji Universum

Këshilli Editorial:

Teuta Agai Demjaha
Arlinda Berisha
Uran Rraci
Uresa Vllasa

Përmbajtja

Motivi

Qëllimet

Hyrja

Metodologjia e punimit

Rai X - personit të intervistuar

Formulimi i pyetësorit

Statistikat sipas pyetësorit

Pyetjet 1-6

Konkluzionet

Rekomandimet

Motivi

Duke e parë nevojën e madhe që ka rinia për t'u larguar nga bota e zyrtë e drogës, vendosa ta bëj këtë hulumtim, edhe pse si temë është shumë e ndjeshme dhe e dhimbshme në të njëjtën kohë.

Qëllimet

Qëllimi im përmes këtij pyetësoari dhe intervistës që kam bërë me personin X ishte të shihja ndikimin e organeve kompetente sa i përket parandalimit të substancave narkotike. Përmes intervistës të përçoja një mesazh se sa e rrezikshme e sa dëm-prurëse është droga. Dhe në fund përmes pyetësorit të shihja se sa janë të informuar të rinjtë sa i përket keqpërdorimit të substancave narkotike.

Hyrje

Drogë ose substancë psikoaktive është cdo substancë e huaj kimike që ndryshon funksionimin e një sistemi biologjik. Shumë substanca mund të shërbejnë si droga, përfshirë qetësuesit e dhimbjeve, alkooli, nikotina, kafeina, antibiotikët, drogat narkotike dhe ato psikoaktive.

Psikofarmakologjia është shkenca e cila studion ndikimin e drogave psikoaktive. Jo të gjitha drogat janë të paligjshme. Për shembull, kafeina (e cila gjendet në kafe ose në pijen "Coca-Cola"), nikotina (e cila gjendet në cigare) dhe alkooli teknikisht janë të gjitha droga të ligjshme edhe pse zakonisht nuk quhen të tilla. Në Kosovë, sidomos pas viteve të '90 droga është përhapur shumë. Apo thënë më mire është bërë një "trend".

Përpyekjet për parandalimin e drogave, e veçanërisht në shkolla të mesme nuk po bëhen aspak.

Metodologjia e kerkimit

Pas dhënies së detyrës nga prof. Teuta Agai Demjaha, është bërë përzgjedhja e temës, formulimi i pyetësorit së bashku me profesoreshën është kërkuar leje nga Kolegji ynë e pastaj edhe nga Drejtoria e Arsimit për t'u bërë ky anketim nëpër shkolla të mesme të Ferizajt.

Fatkeqësisht, Drejtoria e Arsimit nuk e bëri të mundur anketimin në të gjitha shkollat e Ferizajt, gjë që më shtyu të shkoja në gjimnazin ku unë kam vijuar shkollimin dhe aty realizova anketimin.

Anketimi është bërë në mënyrë të rastësishme. Janë përzgjedhur disa nxënës nga klasa dhe ata/ato i janë nënshtruar pyetësorit. Ashtu siç u është premtuar edhe nxënësve, të gjitha të dhënat e tyre janë konfidenciale, pra është respektuar kodi etik i punës.

Intervista e Personit X

“Un jam kan vet i 7 n’familje, domethan baba nana 2 motra edhe un me vllaznit e mi qe jan ma t’mdhej se une. Jam kan fmija ma i dashtun edhe krejt n’shpi m’kan thirre melaqe se jam kan fmia ma i urte. Sja ka prishe qefin kerkujna edhe kam msu kam pas vizion per jete. Derisa Babi.....babi. Babi u kan njeri shume i mire, e di se jam rrite me ta nshpi edhe nuk ka kerkush qe ma ndrron kit mene. Babin e kan myt qitu, para deres shpis, me 4 pluma ntrup. Edhe ata njerz i kofshim fale drejtsis hala jan qitu neper qytet sillen. Masi babi di...sdi...sdi as vet. Veq e di qe se disha kan e kom familje, kan e kom shoqni, ja nisa me pi barin. Senin qe e kom urrejt me shpirt ja nisa me pi edhe vet. Qaty e kom pa qe se kom njoft ma as veten kush jom ba per ni kohe shum t’shkurt. N’shkolle nuk shkojsha bile edhe m’perjashtum qaq shum mungesa qe bana. N’shpi ka 3,4 dite nuk shkojsha, ja kom pervlu shpirtin asaj nane, edhe e di qe sod mu shkri mas sajna nuk muj mi ja kthy ato sene qka ja kom ba.....Pare skena pas as buk me hanger, un ja nisa me vjedh edhe telefona rruges i shitsha qyshtu ka 5 euro, boll mdilshin per ni dit me ble bile. Baza mendore mshkoj shum keq, qaq keq sa me njerz as me fol nuk mujsha, a u kapsha mu rre, a me qdo t dytin qe mdilke perpara u kapsha mu therr krejt...krejt. 2 vjet ren e kom pi barin, dikur ma ja nisi si mu doke kurgjo hiq, mu doke si me pi cigare. Edhe qata, qata shokt qa mkan shti vet me pi barin ma prezentun ni trip tri qka e dishin ata me perzi barin me kokain. Sdisha pse per qfar arsye po hajt e pisha, ma vone mkallxun qe mi perzi bashk nihesh ma HIGH. Tash e asaj dite ska ndryshu kurgjo. Pendona shum, ju thom krejtve t rive mos me pi, krejtve t’rive qka e nijn qit video, krejt qata qka kan me pa qita, MOS E PINI..... Mos e pini se sa e mir qe doket qaq e keqe osht. Besomni qe jeten jau shkatrron, prej zemres po foli. Shkurt e shqip t len pa familje, pa shoqni e ma e rendsishmja pa t ardhme. Skisha pas qef bile as ata qe ma kan inati mi pa nkit deregje si temen... tmerr osht..tmerr.”

Formulimi i pyetëtorit

Pyetëtorin të cilin do ta keni rastin ta lexoni në slajdet më poshtë, është përpiluar në atë mënyrë që:

- të evitohet prekja emocionale e ndonjë individi i cili merr pjesë në këtë pyetëtor;
- të jetë i kuptueshëm dhe i kapshëm për të gjithë pjesëmarrësit.

Në këtë hulumtim është përdorur metoda e *rishikimit të literaturës* nga burime të *internetit*, *punë terreni* (metodë e cila nuk është edhe aq e lehtë duke marrë parasysh edhe rreziqet meqë tema është shumë e ndjeshme), *intervistë* dhe *pyetëtor*.

Statistikat sipas pyetëtorit

Në këtë anketim kanë marrë pjesë moshat:

16vjeç- 43 persona (42.5%)

17vjeç- 53 persona (52.5%)

18vjeç- 5 persona (5%)

Prej tyre **femra** kanë qenë **64.7%** kurse meshkuj 35.3%

Pyetja e parë

Sa dijeni keni për substancat narkotike, rrezikun e përdorimit dhe efektet anësore të tyre?

Aspak	3.8%
Pak	31.7%
Mjaftueshëm	46.2%
Shumë	18.3%

Pyetja e dytë

A mendoni se në shkollën tuaj përdoren narkotikët?

Po	76.9%
Jo	1%
Nuk e di	22.1%

Pyetja e tretë

Nëse PO, a janë ndërrmarë masa nga organet kompetente?

Po	5.8%
Jo	31.7%
Nuk janë interesuar	24%
Nuk e di	38.5%

Pyetja e katërt

Cilat metoda mendoni se të rinjët në shkollën tuaj i përdorin më shumë për të konsumuar substanca narkotike? (Në këtë pyetje mund të përzgjedhni më shumë se një opsion)

Nuhatje (përmes hundës)	15.4%
Pirje (në formë të duhanit)	65.2%
Me shiringë (nëpërmjet venave)	5.9%
Në formë të tabletave (nëpërmjet gojës)	13.5%
Tjetër _____.	

Pyetja e pestë

Cili lloj i substancave të përmendura më poshtë mendoni se përdoret në shkollën tuaj?

Marijuana	81.1%
Kokaina	10.9%
Metamfetamina	1%
Heroina	2%
LSD	5%

Pyetja e gjashtë

Sipas mendimit tuaj cila është arsyeja që nxënësit nga shkolla e juaj konsumojnë substanca narkotike?

Nga dëshira	28.5%
Nga kureshtja	29.4%
Nga depresioni	32.2%
Të “infektuar” nga shoqëria	9.9%

Konkluzionet

- Të intervistuarit janë të moshës 16 vjeçare (42.5%), të moshës 17 vjeçare (52.5%) dhe të moshës 18 vjeçare (5% - kryesisht përsëritës dhe narkoman).
- Shumica nga të intervistuarit (78%) kanë njohuri të mjaftueshme për substancat narkotike.
- 76.9% e të intervistuarve mendojnë se në shkollën e tyre përdoren substancat narkotike.
- 31.7% mendojnë se institucionet përkatëse nuk interesohen fare.
- Metoda më e përdorur është pirja në formë të cigarës (65.2%).
- Marijuana është substanca narkotike më e përdorur (81.1).
- Shkakun më të madh të përdorimit ishte depresioni (32.2%) por edhe të tjerat kanë përqindje mjaft të dukshme.
- Përdorimi i substancave narkotike në shkollën e mesme “Dr:Shaban Hashani” është një realitet dhe problem serioz.

Rekomandimet

-Organet kompetente (policia) e veçanërisht njësitë Anti-Drogë I Kosovës, duhet të marrë masa, sepse sipas pyetësorit të bërë ata nuk interesohen aspak.

-Sa më shumë fushata vetëdijësuese pasi shumica e të rinjëve nuk e kanë as idenë më të vogël se si ndikojnë këto substance në trupin dhe mendjen e tyre.

-Të punohet sa më shumë në ndërtimin e një morali të fortë dhe të pathyeshëm, kuptohet nga ana e prindërve sepse ata janë shtylla e edukimit të një fëmije.

PRISHTINË

Ulpiana Kampus
Rr.Nik Prelaj, Objekti i "Beni Dones"
Tel. +381 38 555 315
Mob. + 377 44 144 062, 44 168 531
Skype: universum.college

FERIZAJ

Rr.Fan Noli, Nr.156
Tel. +381 290 324 596
Mob. + 377 44 354 034
Skype: universum-ferizaj

GJAKOVË

Rr.UÇK-së, përball pallatit të kulturës
Tel. +381 0390- 330990
Mob. + 377 44 750 858
Skype: universum-gjakova

Kolegji Universum është institucion i arsimit të lartë, i akredituar pa kusht nga Agjencia për Akreditim e Kosovës. Programet e studimit, menaxhimi institucional dhe sigurimi i cilësisë janë vlerësuar shumë lartë nga ekspertët ndërkombëtarë (shih raportet e akreditimit).

Universum në partneritet me programin Erasmus+ të financuar nga Bashkimi Evropian, ka dërguar për studime jashtë vendit 47 studentë në 44 Universitete Ndërkombëtare të Evropës.

Universum ka partneritetet më të fuqishme ndërkombëtare nga të gjitha institucionet që veprojnë në Kosovë. Është i binjakëzuar me Chichester College (Angli), anëtarësuar në Global College Network, Anglia Network Europe, European Higher Education Society dhe ka mëse 30 institucione partnere nga e gjithë bota.

Universum është renditur në Top 1000 Shkollat më të mira të biznesit në Botë nga Eduniversal, si i vetmi institucion nga Kosova.